

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR EKSPERT TË LARTË PËR KOMUNIKIM DHE VIZIBILITET

Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë Teknike për përmirësimin e mjedisit të favorshëm për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut"
Numri i identifikimit: EuropeAid/140131/DH/SER/MK

Projekti i financuar nga BE-ja "Asistencë teknike për përmirësimin e mjedisit të favorshëm për Organizatat e Shoqërisë Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut" është në kërkim të një Eksperti të Lartë jo-kyç me përvojë për mbështetjen e zbatimit të projektit. Projekti synon të mbështesë Qeverinë në mundësimin e mjedisit për shoqërinë civile në të njëjtën kohë të ofrojë mbështetje për organizatat e vogla dhe bazë në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive të tyre operacionale të qëndrueshme.

Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Corporate & Public Management Consulting International (CPM) përmes dy komponentëve: Komponenti 1) Mbështetja e zbatimit të objektivave kryesore nga Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2018-2020) – Prioriteti I , dhe Komponenti 2) fokusim në zbatimin e mbështetjes së drejtpërdrejt jomateriale përmes Mekanizmit të Qëndrueshmërisë Civile (CRM) të përshtatur për nevojat e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Programi MQC ofron mbështetje të drejtpërdrejtë fleksibile, transparente dhe me mundësi për akses për punën e bazuar në të drejtat dhe përfitimet publike të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile.

EKSPERT I LARTË DYTËSOR PËR KOMUNIKIM DHE VIZIBILITET

Inputet: Deri në 45 ditë pune midis gushtit 2023 dhe marsit 2024 (një pozicion)

Kualifikime dhe aftësi:

- Diplomë universitare në komunikim dhe arte mediatike (CMA), gazetari multimediale (MJ), drejtësi, administratë publike, shkenca politike, shkenca shoqërore, ekonomi ose ndonjë fushë me rëndësi për detyrën; Në mungesë të diplomës universitare, përvojë ekuivalente profesionale të paktën 5 vjet përveç kërkesës për të paktën 7 viteve përvojë të përgjithshme profesionale
- Aftësi të mira komunikimi dhe kompjuterike (punë me Microsoft Office (Word, Excel, Power point, etj.) dhe Internet)
- Njohuri shumë të mira në media sociale dhe mjetet e tjera të komunikimit
- Gjuha: zotërim i shkëlqyer i gjuhës angleze të shkruar dhe të folur
- Aftësi të jashtëzakonshme të komunikimit dhe aftësi ndërpersonale
- Aftësi të shkëlqyera për shkrim dhe analitikë

Përvojë e përgjithshme profesionale:

- Të paktën 7 vjet përvojë pune të përgjithshme profesionale në fushat përkatëse për detyrën.

Përvojë specifike profesionale:

- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për vlerat, politikat dhe programet e BE-së;
- Të paktën 3 përvoja nga projekte në menaxhim me komunikime dhe dukshmëri për mbështetje të financuar nga BE;
- Të paktën 1 përvojë në projekt në lidhje me përmirësimin e dukshmërisë së OSHC-ve dhe punës së tyre;
- Përvoja në punën me dhe menaxhimin e ofruesve të ndryshëm të shërbimeve në mbështetje të vizibilitetit dhe strategjisë së komunikimit të projektit është një avantazh.

Përgjegjësitë:

- Të sigurojë mbështetje për ekipin e projektit të AT në mbikëqyrjen dhe koordinimin e aspekteve të komunikimit dhe vizibilitetit të zbatimit të programit të mbështetjes në natyrë të MQC-së dhe veprimeve përkatëse të MQC-së. Eksperti gjithashtu do të ofrojë ndihmë në ofrimin e këshillimit për Përfituesit e MQC-së për aktivitetet e tyre të komunikimit, si dhe këshilla praktike se si të komunikojnë më mirë veprimet e mbështetura nga MQC të BE-së në përputhje me 'Komunikimin dhe ngritjen e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për aksionet e jashtme'.

APLIKIMI

Kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme, duhet të dorëzojnë një CV të formatit BE në gjuhën angleze në recruitment@cpmconsulting.eu dhe kepuska@cpmconsulting.eu deri më **17 gusht 2023 në orën 16:00 CET**. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtë do të kontaktohen me e-mail. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

